



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 30.3.2023

Nr: 225

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**VLERËSIMIN E RAPORTIMEVE TË VEPRIMTARIVE ME KARAKTER PUBLIK TË INSTITUCIONIT TË  
PRESIDENTIT DHE DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHETIT, PËR PERIUdhËN  
10 MARS – 16 MARS 2023**

Sot, më datë 30.3.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me,

**SUBJEKT:** Institucioni i Presidentit  
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

**OBJEKTI:** Vlerësim i raportimeve të veprimtarive me karakter publik të Institucionit të Presidentit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për periudhën 10 mars deri më 16 mars 2023.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 19 pika 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

Data: 30.3.2023 Nr: 225  
Ora: 11:00



“Për vlerësimin e raportimeve të veprimtarive me karakter publik të Institucionit të Presidentit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për periudhën 10 Mars – 16 Mars 2023”

## KONSTATOJ:

Gjatë periudhës së monitorimit 10 mars deri më 16 mars 2023, Institucioni i Presidentit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, kanë raportuar në ndërfaqen e raportimeve të KQZ-së, 3 (tre) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor. Më datë 17.3.2023, administrata e KQZ - së i ka kërkuar institucioneve nëpërmjet email-it, informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljeve, si dhe të drejtën e tyre për t'u paraqitur në seancën publike të datës 24.3.2023, ora 11:00. Institucionet depozituan pranë KQZ-së pretendimet e tyre si vijon:

1. Institucioni i Presidentit ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:
  - Aktivitet *“Gruaja – Shpirti i thesareve tona etnografike”*, raportuar në datë 13.3.2023 dhe datë zhvillimi 15.3.2023.

Institucioni i Presidentit nëpërmjet emailit të datës 20.3.2023 ka paraqitur pretendimet e tij dhe ka sqaruar se: *“Në vijim të email-it tuaj ju informoj se duke mos pasur kredenciale ju kam dërguar email mbi aktivitetin në datën 9.3.2023, në adresën denoncime@kqz.gov.al, në datën 13.3.2023 ju me keni dërguar kredencialet dhe po ate datë e kam raportuar përsëri.”* Bashkëlidhur email –it ka dërguar edhe komunikimin elektronik me KQZ – në.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura konstaton se, Institucioni i Presidentit, nëpërmjet pretendimeve të dërguara, ka provuar që nuk ka patur akses për të hyrë në ndërfaqen e raportimeve të KQZ –së. Në këto kushte, ai ka dërguar raportimin e veprimtarisë nëpërmjet email – it denoncime@kqz.gov.al, në datë 9.3.2023, që është brenda afatit 5 (pesë) ditor të raportimit. Për këtë arsye, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerëson se nuk jemi përpara kundërvajtjes administrative.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:
  1. Aktivitet *“Informimi i partnerëve ndërkombetare që asistojnë Policinë e Shtetit lidhur me riorganizimin strukturor të Policisë së Shtetit”*, raportuar në datë 10.3.2023 për t'u zhvilluar në datë 10.3.2023.
  2. Aktivitet *“Takime Sensibilizuese dhe ndërgjegjësuese me Komunitetin për Parandalimin e Kultivimit të Bimëve Narkotike në 12 Qarqet e Vendit”*, raportuar në datë 16.3.2023 për t'u zhvilluar në datë 20.3.2023.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, nëpërmjet email-it të datës 20.3.2023, ka paraqitur pretendimet e saj dhe ka sqaruar se: “ Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është njohur dhe po zbaton detyrimet për organet publike për të raportuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve mbi veprimtaritë e tyre për periudhën 4 muaj përpara datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve, të përcaktuara në nenin 92, të Kodit Zgjedhor dhe Vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator. Në lidhje me 2 (dy) raportimet e bëra në datat 10 Mars dhe 16 Mars 2023 në ndërfaqen e raportimit të veprimtarive publike në KQZ, Ju informojmë si vijon: Lidhur me aktivitetin e parë, të zhvilluar në datë 10 Mars 2023 në Akademinë e Sigurisë, si aktivitet i brendshëm policor, nuk është pasqyruar në asnjë media, televizion, shtyp, faqe interneti, media online, në rrjete sociale ose në ndonjë rrjet tjetër që mundëson publikun e gjerë të njihet apo të informohet për këtë veprimtari, kjo në respekt të afateve të përcaktuara në nenin 92, të Kodit Zgjedhor dhe Vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator. Lidhur me aktivitetin e dytë në respekt të nenin 92, të Kodit Zgjedhor dhe Vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator të parashikuara për tu zhvilluar në 12 qarqet e vendit nga data 20 Mars 2023 deri më datë 04 Prill 2023, dhe do të bëhen të njohura për publikun në datën 21 Mars 2023 e në vijim. Për shkak të natyrës së shërbimit dhe emergjencave që karakterizojnë veprimtarinë e Policisë së Shtetit ndodh që planifikimi i aktiviteteve të ndryshme, të bëhet në një afat më të shkurtër se pesë ditë, dhe në këto rrethana do të dëshironim mirëkuptimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që ky informacion të jetë sqarues për këto raste. Strukturat e Policisë së Shtetit janë të angazhuara maksimalisht për respektimin e Kodit Zgjedhor dhe akteve të tjera me karakter normativ të nxjerra nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, lidhur me procesin zgjedhor.”

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerëson se lidhur me aktivitetin e parë “Informimi i partnerëve ndërkombëtare që asistojnë Policinë e Shtetit lidhur me riorganizimin strukturor të Policisë së Shtetit”, nisur nga tematika dhe nga sa informacion jepet në raportimin e kryer në ndërfaqe (pa pjesëmarrjen e medias dhe jo e hapur për publikun), nuk krijohet bindja mbi karakterin publik që ka kjo veprimtari.

Lidhur me aktivitetin e dytë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve konstaton se në datën 16.3.2023 nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit janë raportuar disa takime sensibilizuese dhe ndërgjegjësuese me komunitetin për parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike në 12 Qarqet e Vendit, të cilat do të zhvillohen nga data 20.3.2023 deri në datë 4.4.2023. Raportimi i kryer është në shkelje të afatit vetëm për aktivitetin që do të zhvillohet në datë 20.3.2023, ndërsa për të tjerët është brenda afatit ligjor. Nisur nga natyra emergjente e veprimtarive dhe mbështetur në faktin se vonesa është vetëm për njëjërën veprimtari me një ditë tejkalim afati, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mirëkupton Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit duke mos sanksionuar atë.

## PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, dispozitat e ligjit nr. 10279, datë 20.05.2012 “Për kundërvajtjet administrative”, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

## VENDOS:

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj Institucionit të Presidentit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
2. Ky vendim do të njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: 30.3.2023 Nr: 225  
Ora: 11:00



“Për vlerësimin e raportimeve të veprimtarive me karakter publik të Institucionit të Presidentit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për periudhën 10 Mars – 16 Mars 2023”